



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 979, datë 2.12.2020

P Ë R

**PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN
E HARTIMIT TË PROJEKTIT TË NDËRHRYJEVE
REHABILITUESE/PËRSHTATËSE TË NEVOJSHME PËR KTHIMIN
E STRUKTURËS SË OBJEKTEVE, QË JANË KLASIFIKUAR
SI OBJEKTE ME DËMTIME TË MËDHA STRUKTURE
OSE DËMTIME SHUMË TË RËNDA JOSTRUKTURE,
NË BASHKINË KAMZË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", e 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.88/2019, "Për buxhetin e vitit 2020", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 19 323 960 (nëntëmbëdhjetë milionë e treqind e njëzet e tre mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) lekë, për financimin e hartimit të projektit të ndërhyrjeve rehabilituese/përshtatëse, për ndërhyrjet strukturale të nevojshme, për njësitë e banimit në ndërtesa (pallat), bazuar në rekomandimet e aktekspertizave të thelluara të bëra nga Instituti i Ndërtimit, në Bashkinë Kamzë.
2. Efekti financiar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, përballohet nga pjesa e financuar nga grantet e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2020, dhe i transferohet Bashkisë Kamzë.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kamzë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERION BRACE

**MINISTRI I SHETIT
PËR RINDËRTIMIN**

ARBEN AHMETAJ

NR.PROT. 6089/1
DATE 3.12. 2020

MINISTRIT TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN ✓
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
BASHKISË KAMZË
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI

